

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

-OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale elektrike për mirëmbajtjen e rrjetit të ndricimit të shkollave, kopshteve, rrugëve dhe institucioneve në varësi të Bashkisë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31681410-0 Materiale elektrike.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,414,666 (një milion e katërqind e katërmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, , autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 35% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në:nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëzbatimtëLigjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5,datë 30.01.2006,"Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar,VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore,vetëm nëpërmjet formes elektronike",si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqitet kontrata e lidhur e shoqëruar me vërtetimin përkatës të lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Ose

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2.Operatori duhet të paraqesë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit mostrat e materialeve të mëposhtme të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia
1	Çelsa ndricimi 10A brenda murit	Cope	1
3	Celesa te thjeshtë rumbullakë	Cope	1
4	Drozula led 50W per koka led	Cope	1
6	Izolant (nastro)	Cope	1
7	Kabull Al 2x16mm	Ml	1
8	Kabull bakri frexibel 3x1.5 mml	Ml	1
9	Kabull bakri frexibel 3x2.5 mml	ml	1
10	Kabull bakri frexibel 3x4 mml	ml	1
11	Kabull bakri frexibel 4x6 mml	ml	1
14	Kapikorda Ø 16(klema)	Cope	1
15	Kapikorda Ø 32(klema)	Cope	1
16	Kapikorda Ø 25(klema)	Cope	1
17	Kuti celesash 3 modul	Cope	1
19	Limitator 1fazor 20 A	Cope	1
20	Limitator 1fazor 25 A	Cope	1
22	Limitator 16 A	Cope	1
23	Llampa led 50W per koka 50 W per ndricimin rrugor	Cope	1
24	Llampa 125W me drozul	Cope	1
25	Llampa 250W me drozul	Cope	1
26	Llampa Led 30W	Cope	1
27	Llampa Led 40W	Cope	1
28	Llampa led 40 W per ndricimin rrugor	Cope	1
29	Llampa led 65 W per ndricimin rrugor	Cope	1
30	Llampa led 50W per ndricimin rrugor	Cope	1
31	Ndricules Led 100W	Cope	1
32	Ndricules Led 50W	Cope	1
33	Pllakon 60x60 40W	Cope	1
34	Pllakon 30x30 28W	Cope	1
35	Portollamba	Cope	1
36	Priza shuko universal	Cope	1
37	Prize treshe me kabull deri 5 ml 3x2.5	Cope	1
38	Suporte	Cope	1
41	Tel elektrik Ø2,5 mm2	Ml	1

42	Tel elektrik Ø1,5 mml	Ml	1
43	Tel elektrik Ø4 mml	Ml	1
44	Tube Φ20 (xhevis)	ml	1
47	Xhama per ndricues 125W	Cope	1
48	Monseta togezimi	Cope	1
51	Kabull bakri frexibel 2x1.5 mml	ml	1

Mostrat do të dorëzohen pranë zyrës së Këshillit, Bashkia Prrenjas jo më vonë se data dhe ora e hapjes së procedures së prokurimit.

Argumentimi: Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e mostrave të mallit është përcaktuar proporcionalisht dhe në përputhje me objektin e kontratës, bazuar në nenin 77, të LPP, si dhe nenin 40, par.6, pika a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë përputhshmerinë e mallrave me standartet teknike si dhe për të garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik 1 ” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet se,: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat e përshtatshme ose ekuivalentet e tyre si më poshtë:

- a) **ISO 9001-2015** – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente

Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” . Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësise, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit